



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 6824
Data: 22.08.2025

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR TË DEDIKUAR PËR SHOQATËN
HANDIKOS PËR DRAFT BUXHETIN PËR VITIN 2026 DHE PARASHIKIMET PËR
VITET 2027-2028**

Procesverbali nga Dëgjimi i katërt Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028, të mbajtur me datën **12.08.2025**, duke filluar nga ora **10:00** në **Salla e Takimeve në katin e parë të objektit të Komunës**, me gjithsej 10 pjesëmarrës/e, prej tyre 5 gra dhe 5 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Mehmet Ballazhi**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**, si dhe nga Zyra e Kryetarit dhe disa nga drejtorët/et e drejtorive.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z.Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve, të cilët kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2026, si dhe parashikimi për vitet 2027-2028, ku për rend të punës, kishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**
2. **Diskutimi**

Mehmet Ballazhi: Sot jemi në dëgjimin e radhës buxhetor , i cili sot është i dedikuar për Shoqatën Handikos dhe ka të bëjë me Draft buxhetin e vitit 2026 dhe parashikimet e hershme 2027-2028. Ne kemi organizu takime me kategori të ndryshme që me mujt prej secilës me i amrr propozimet që të përfshihen në buxhet, i cili është mjaft i kufizuar mirëpo duke u abzuar gjithmonë që kërkesat të jenë brenda buxhetit. Kërkesat janë tepër të mëdhaja, ndërsa buxheti mjaft i ulët, dhe mundësitë tepër të vogla me u realizu të gjitha kërkesat.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor, në veçanti Donjeta Morinën e cila ka ndihmuar shumë në procesin e planifikimit buxhetor , si në KAB gjithashtu edhe tash në draft buxhet).

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti në disponim për vitin 2026 është 4,234,682 €, prej tyre e dedikuar për investime kapitale është shuma 891,140 €. Tjetër që vlen të theksohet është se subvencionet i kemi rritur për vitin tjetër. Nëse keni ndonjë propozim, ne jemi të hapur për t'i

dëgjuar dhe më pas këto do të dërgohen për diskutim dhe shqyrtim me grupin punues për hartimin e draft buxhetit.

2. Diskutimi

Mehmet Ballazhi: Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit. Nëse keni ndonjë sugjerim, rekomandim, kërkesë për buxhetin e vitit 2026.

Nerxhivane Berisha: Ju e dini që ne si Shoqatë Handikos dy i kemi kërkesat kryesore, e para është rehabilitimi i anëtarëve në bajë dhe e dyta është kërkesa e anëtarëve për me vizitu Prekazin. Për rehabilitimin në bajë, nëse do të ishte mundësia me e rrit numrin e anëtarëve, ku vitin e kalum i kemi pas 17 anëtarë që na i keni përfshirë.

Mehmet Ballazhi: Për rehabilitimin në bajë, ne besoj se do të kemi mundësi me e rrit numrin së paku 20 persona sepse besoj se do të kemi mundësi buxhetore, poashtu edhe te Shoqata e Pensionerëve, ashtu siç kemi rrit edhe bursat e studentëve. Dmth ne jemi mundu që gjithkund ku ka pasur nevojë dhe mundësi, me i rrit subvencionet. Kurse kërkesa për me shku në vizitë në Prekaz besoj se do të ishte shumë e mundshme me u realizu edhe brenda këtij viti, vetëm se do të duhet me u ndjekë procedurat.

Nerxhivane Berisha: Shërbimet e pulmologes në QKMF na kanë ndihmu shumë, gjithashtu edhe kardiologu. Por e kisha pas si kërkesë, me mujt me u ofru shërbime të fizioterapisë falas së paku 1-2 herë në javë.

Lindita Ballazhi: Për vitin 2026 ne i kemi të aprovuara 4 pozita të lira në sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, të cilat janë fizioterapeut, psikolog, logoped dhe punëtor social, ku pra edhe fizioterapeuti do të jetë me vendim të përhershëm në QKMF në Han të Elezit.

Nerxhivane Berisha: E kisha edhe një kërkesë. Qaty te pjesa e rrugës që shkon te parku mbrapa shpis teme, u kan një pjesë që kam mujt me kalu me karrocë, një hekur...por kur pat ra shiu i madh me vërshime e kanë hjek atë hekurin e kanë qit kah kjo ana e bicigllave, anën e kundërt dmth, edhe e patën hjek se nuk ngrehej uji te ai kanali. E me mujt me u vendos knej kah shpijat e tona . Ajo u kan qysh kur e kena bo kërkesën, po shkaku i shiut e patën hjekë.

Mehmet Ballazhi: Po, edhe kjo kërkesë është shumë e arsyeshme, edhe besoj se mundet me u rregullu, Po e mbajmë shënim këtë kërkesë, edhe çdo kërkesë tjetër, edhe do të shohim mundësinë e realizimit të tyre brenda këtij viti ose vitin e ardhshëm varësisht kërkesës apo rekomandimit. A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 10:35.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi

